



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANÇAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Adresa Org. Org. Jendrace Org. Unit	10/23
Nr. I Fajrove Br. Stranica No. Pages	11/4
Prishtinë / a	
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	10/23
Data : Datum : Date :	06.05.2023

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfer - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agjencia Nabavke-Central Procurement Agency

KONTRATË KORNIZË PËR FURNIZIME

Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune dollap dhe karriga me numër të prokurimit

TITULLI I KONTRATËS:

LOT 2 FURNIZIM ME INVENTAR ZYRTAR KARRIGA PUNE

NUMRI I PROKURIMIT: AQP 22-019-111

NUMRI I BRENDSHËM: UA/2016-22-14086-1-1-1

PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

1. **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe
2. Grupi i Operatorëve Ekonomik **"GRANITI" SH.P.K. - Suharekë**, me NUI: 810631996 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

LOT 2 FURNIZIM ME INVENTAR ZYRTAR KARRIGA PUNE

Me numër identifikues: UA/2016-22-14086-1-1-1& AQP 22-019-111 / C315

Agjencia Qendrore e Prokurimit bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese të specifikuar në **Vendimin e Qeverisë 15/67 të datës 09 mars 2022**.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese (Niveli Qendror & Lokal) të specifikuar në **Vendimin e Qeverisë 15/67 të datës 09 mars 2022** të Dosjes së Tenderit.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese të specifikuar në **Aneksin Nr. 7 dhe Vendimin e Qeverisë 15/67 të datës 09 mars 2022**.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në **Aneksin Nr. 7 dhe Vendimin e Qeverisë 15/67 të datës 09 mars 2022**.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative. Autoriteti (et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 04 maj 2023 dhe përfundon me 03 maj 2024

Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 12 muaj dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hynë në fuqi.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë [30] ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë të specifikuar në **Aneksin Nr. 7**

¹⁶ Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese **shih: Aneksin nr. 7**
Në rast të blerjes në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese bazë do të jetë **Vendimi i Qeverisë Nr. 15/67 i datës 09 mars 2022.**

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP² (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve (nëse kërkohet dhe nëse ka nevojë), më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi Vlera totale indikative e kontratës është **383,777.00 € (Treqind e Tetëdhjetë e Tremijë e Shtatëqind e Shtatëdhjetë e Shtatë euro)**. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është (+-) 30%

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë]

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.


Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]³ in në tri origjinale, Dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES		PËR KONTRAKTUESIN	
PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES		PËR KONTRAKTUESIN	
EMRI:	MEHMET RAMA	EMRI:	BAJRAM LUMI
POZITA:	ZPP	POZITA:	DREJTOR
NËSHKRIMI:		NËSHKRIMI:	
DATA:	04 maj 2023	DATA:	04 maj 2023
VULA:		VULA:	

PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES	
PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES	
EMRI:	BEHXHET RRUQIQI
POZITA:	ZKA
NËSHKRIMI:	
DATA:	04 maj 2023
VULA:	

¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES: KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që

nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet Brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose

licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit Brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jene të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore Brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhëra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të

Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimi, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimi.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të

konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkojnë për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimi derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimi të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimi, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdher, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhën ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimi, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si

dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto

kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh

dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Transferimi	3	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit, transferimi lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit, nënkontraktimi lejohet gjatë fazës së implemtimit vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Njësitë kërkuuese. Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 5 (pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta caktoj Menaxherin dhe ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës dhe me një kopje duhet të Njoftohet AQP-ja.
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Në AQP, Furnizuesi me shkrim do të raportoj në baza 3 (tre) mujore në 9 (nëntë) muajt e parë, ndërsa në baza 1 mujore në 3 muajt e fundit të kontratës, lidhur me sasinë e Inventares të dorëzuara tek secili autoritet Kontraktues. Një fletë e veçantë duhet të përgatitet për secilin Autoritet Kontraktues. Raporti duhet të paraqesë: 1. Sasinë e mallrave të dorëzuar; 2. Llojin e artikujve; 3. Datën e faturave; 4. Datën e pagesave; 5. Raportin lidhur me dëmet e likuiduara. Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj të Furnizuesi jo më vonë se 20 dite nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi që ta shfrytëzojë këtë

		model te Raportit gjatë raportimit te AQP-ja. Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e Furnizuesit, e detyron AQP-në që të marrë masa, siq është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshuarja e Referencës negative për kontratën e nënshkruar.
Obligimet e përgjithshme te Furnizuesit	7.2	Operatori Ekonomik obligohet që për produktet e dorëzuara dhe të pranura nga Njësia kërkuese të garantoj së paku 12 muaj nga data e përfundimit të kontratës dhe sa herë që i kërkohet brenda 15 ditëve duhet t'i eliminojë defektet.
Obligimet e përgjithshme te Furnizuesit	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qëndrore te Prokurimit.Furnizuesi do te emërojë një përfaqësues (Menaxher), i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për te gjitha çështjet qe lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet te jetë në dispozicion çdo here qe kërkohet dhe do te këtë autoritetin e duhur për te marre vendime te shpejta dhe te zgjidhe çështjet qe lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Siguria e ekzekutimit	8.1	Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do te dorëzoj tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës se parashikuar te kontratës për secilin Lot për kohëzgjatje prej 13 muajsh.
Përmiresimi i defekteve	9	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj nga përfundimi i kontratës. Brenda 10 ditëve pas përfundimit të kontratës kërkohet të ofrohet Garancia e performances për eliminimin e të metave, nga ndonjë kompani e licensuar, në shumën prej 10% të vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 12 muajve.

Sigurimi	10	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Periudha e ekzekutimit të detyrave	12	Kurdo që ndonjëri nga Njësia e kërkesës si palë të kësaj kontrate dëshirojnë që të blejnë artikuj Inventar sipas kësaj kontrate, duhet që të dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	13	Autoriteti Kontraktues në nenin i referohet cilit do Njësi kërkuese të identifikuar në Aneksin 7, zgjatja e periudhës së ekzekutimit lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK / Menaxheri.
Vonesat në ekzekutim	14	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Vonesat në ekzekutim	14.1	Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Njësia kërkuese (Menaxheri), pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Njësia e Kërkesës mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.
Suspendimi	15	Autoriteti Kontraktues në këtë nen referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Cilësia e furnizimeve	16.1	Njësitë e Kërkesës të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë të mallit i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin dhe AQP-në.
Cilësia e furnizimeve	16.2	Për furnizimin me artikuj Inventar Njësitë e kërkesës të specifikuara në Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm. Pasi që të shkarkohen mallrat tek Autoritetet Kontraktuese, dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Njesisë kërkuese malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës kornize.
Pagesat	18	Pagesa do të bëhet nga ana e secilit Autoritetit Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7 për artikujt vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga cilitdo autoritet kontraktues i specifikuar në Aneksin 7. Kërkesat për pagese do të bëhet vetëm për artikujt Inventar në

		baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas dorëzimit të çdo malli, Furnizuesi duhet të dorëzoj tek secili AK i specifikuar në Aneksin 7 një faturë origjinale dhe një kopje për artikujt të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm.
Vonesa ne pagesa	18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Njësinë e kërkesës përkatëse dhe Agjencinë Qendrore te Prokurimit.
Raportimi pranë AQP-së		Në rast se kërkohet nga AQP-ja, Autoriteti kontraktues obligohet të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e artikujve Inventar të pranuar nga Kontraktuesi - Furnizuesi. Raporti duhet të paraqesë: Sasinë e mallrave të pranuar për periudhën e kërkuar 1. Llojin e artikujve; 2. Datën e pranimi të faturave; 3. Datën e pagesave; 4. Raportin lidhur me dëmet e likuiduara. Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model te Raportit dhe do ta dërgoj AK-së me rastin e kërkesës për raportim. Obligohet AK-ja që ta shfrytëzoj këtë model të Raportit gjatë raportimit në AQP.
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranim. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Porositë dhe Dërgesat do të bëhet brenda: Porositë bëhen vetëm pasi Kontraktuesi pranon Urdhërblenjen zyrtarisht nga ana e Autoriteteve kontraktuese dhe duhet të bëhen sipas nevojave që autoriteti i kanë, ndërsa dërgesat apo dorëzimi i furnizimeve duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Autoritetet kontraktuese do të bëjnë përpjekje që brenda 30 ditëve të kryhen pagesat nga data e pranimi të produkteve. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00). Anulimi i porosisë: Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para

		kohës së liferimit të porositur.
Verifikimi i operimeve	20	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues te identifikuar ne Aneksin 7.
Dorëzim / pranimi dhe inspektimi i produkteve	20.1	Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave. Produktet e dorëzuara nga kontraktori dhe të pranuar nga Njësia kërkuese duhet të janë në përputhje me standardet mbi specifikimet teknike.
Pranimi i përkohshëm	21	Për furnizim me artikuj Inventar Njësistë Kërkuese të specifikuar ane Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.
Obligimet e garancionit	22.1	Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Operatori Ekonomik obligohet që për produktet e dorëzuara dhe të pranuar nga Njësia kërkuese të garantoj së paku 12 muaj dhe sa herë që i kërkohet brenda 15 ditëve duhet t'i eliminojë defektet.
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	26	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit me propozimin e Njësive kërkuese.
Ndërprerja e Kontratës nga Furnizuesi	27	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet cilitdo Njësi e kërkesës të identifikuar ne Aneksin 7.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.1	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit. Njësia e kërkesës duhet të bëjë përpjekje të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Furnizuesin.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet ne mënyre miqësore , përgjegjës për zgjidhjen e tyre do te jene personat përgjegjës te Njesisë së Kërkesës , dhe zyrtaret përgjegjës që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të ofruesit të shërbimeve. AQP vetëm jep ndihmë në zgjidhjen e mosmarrveshjeve eventuale.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjet e Kosovës.

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

LOT 2: Furnizim me inventar zyrtar - Karrige

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia matëse	sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	Pozicioni 1 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	151	98.00	14,798.00
2	Pozicioni 2 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	292	78.00	22,776.00
3	Pozicioni 3 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	1168	69.00	80,592.00
4	Pozicioni 4 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	477	62.00	29,574.00
5	Pozicioni 5 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	410	79.00	32,390.00
6	Pozicioni 6 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	469	75.00	35,175.00
7.1	Pozicioni 7.1 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	114	120.00	13,680.00
7.2	Pozicioni 7.2 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	158	90.00	14,220.00
8	Pozicioni 8 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	1043	59.00	61,537.00
9	Pozicioni 9 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	247	55.00	13,585.00
10	Pozicioni 10 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	295	70.00	20,650.00
11	Pozicioni 11 sipas Aneksit 1 te dosjes së tenderit	Copë	800	56.00	44,800.00
LOT 2: Totali me TVSH			5624		383,777.00

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative.

Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është $\pm 30\%$ e vleres se parashikuar.

EMRI OE: Graniti shpk

NËSHKRIMI: _____



ANEKSI 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) .

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Njësitë Kërkuese;
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë nr 15/67 të datës 09 mars 2022, AQP është autorizuar që të fillojë me procedurat qendrore për Furnizim me Inventar në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese Aneksin nr. 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me produkte inventarit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të produkteve të inventarit nga cilido shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur mallrat të dorëzohen në pronësi të AK. Produktet e dorëzuara nga kontraktori dhe të pranuar duhet të jenë në përputhje me EN & ISO standardet mbi specifikacionet teknike.

AK të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë e cila dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës do të shpërndajë nga një kopje të nënshkruar të kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7. Një kopje e kontratës së nënshkruar do të publikohet në webfaqen e AQP-se.

Disa Njësive Kërkuese të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë kontratat e tyre ekzistuese. Këto kontrata nuk do të ndërpriten, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy javë para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftojë me shkrim Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe Operatorin ekonomik lidhur me datën e skadimit të kontratës dhe datën e fillimit të shfrytëzimit të kontratës kornizë.

Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar në Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë fokale ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.


Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve. Nëse një autoritet kontraktues ka dyshime në kualitetin e inventarit gjatë pranimi / implementimit të Tijë, atëherë mund të kërkoj dëshmi rreth standardit të atij artikulli.

Lot 2: Furnizim me inventar zyrtar - KARRIGE

Nr.	Pershkrimi	Foto-ja,	Sasia për 12 muaj
1.	Karrige lëvizëse ekzekutive me mbështetëse të lartë e cila duhet të jete e punuar me strukture monoblok e mbuluar me sfungjer të shtypur i formuar nga myku special me 45-50 densitet DNS (kg / m³) në plastikë të posaçme, ulësja duhet të jete nga tubi metalik me sfungjer të ngjeshur me 45-50 densitet DNS (kg / m³) ergonomike, mbajtëset e duarve të jene të kromuara me metodën e injektimit të mveshur me eko-lëkure. Sinkro mekanizmi i rregullimit të mbështetëses para dhe mbrapa në katër pozicione, gas lift i klasit të 4 sipas normave europiane DIN dhe trungj absorbues, baza e aluminit të injektuar me myk të veçantë me diametër 65cm në formë piramidale, rrotat të jene pa vide me diametër 65mm. Mveshja e sfungjerit të jetë me Eko-Lëkurë. Dimenzionet – L71 W76 H126		151
2.	Karrige lëvizëse ekzekutive me mbështetëse të ulët e cila duhet të jete e punuar me strukture monoblok e mbuluar me sfungjer të shtypur i formuar nga myku special me 45-50 densitet DNS (kg / m³) në plastikë të posaçme, ulësja duhet të jete nga tubi metalik me sfungjer të ngjeshur me 45-50 densitet DNS (kg / m³) ergonomike, mbajtëset e duarve të jene të kromuara me metodën e injektimit të mveshur me Eko-Lëkure. Sinkro mekanizmi i rregullimit të mbështetëses para dhe mbrapa në katër pozicione, gas lift i klasit të 4 sipas normave europiane DIN dhe trungj absorbues, baza e aluminit të injektuar me myk të veçantë me diametër 65 cm në formë piramidale, rrotat të jene pa vidë me diametër 65mm. Mveshja e sfungjerit të jetë me Eko-Lëkurë. Dimensionet – L71 W64 H103		292
3.	Karrige lëvizëse me mbështetëse të lartë e cila duhet të jete e punuar me strukture monoblok e mbuluar me sfungjer të shtypur i formuar nga myku special me 45-50 densitet DNS (kg / m³) në plastikë të posaçme, ulësja duhet të jete nga tubi metalik me sfungjer të ngjeshur me 45-50 densitet DNS (kg / m³) ergonomike, mbajtëset e duarve të jene të kromuara me metodën e injektimit të mveshur me Eko-Lëkure. Sinkro mekanizmi i rregullimit të mbështetëses para dhe mbrapa në katër pozicione, gas lift i klasit të 4 sipas normave europiane DIN dhe trungj absorbues, baza e aluminit të injektuar me myk të veçantë me diametër 65cm në formë piramidale, rrotat të jene pa vide me diametër 65mm. Mveshja e sfungjerit të jetë me Eko-Lëkurë. Dimensionet – L64 W48 H122 .		1168

4.	Karrige lëvizëse me mbështetëse te ulet e cila duhet te jete e punuar me strukture monoblok e mbuluar me sfungjer te shtypur i formuar nga myku special me 45-50 densitet DNS (kg / m³) në plastikë të posaçme, ulësja duhet te jete nga tubi metalik me sfungjer te ngjeshur me 45-50 densitet DNS (kg / m³) ergonomike, mbajtëset e duarve te jene te kromuara me metodën e injektimit te mveshur me Eko-Lëkure. Sinkro mekanizmi i rregullimit te mbështetëses para dhe mbrapa ne katër pozicione, gas lift i klasit te 4 sipas normave europiane DIN dhe trungj absorbues, baza e aluminit te injektuar me myk te vecante me diametër 65cm ne formë piramidale, rrotat te jene pa vide me diametër 65mm. Mveshja e sfungjerit të jetë me Eko-Lëkurë. Dimensionet – L64 W48 H101.		477
5.	Karrige lëvizëse me mbështetëse te kokës nga rrjeta e shtrire në kornizën metalike te formuar me myk te veçantë, pjesa e ulësës te jete me sfunxher te densitetit 50-55 DNS, te ketë mekanizëm me shume mundësi rregullim të pjerrësisë mbrapa, të ketë mbështetëse lumbare. Mbajtëset e duarve te jene lëvizëse poshtë/lart. Amortizuesi te jete i cilësisë se klasës 4 që është në përputhje me normat DIN evropiane dhe që ka karakteristikat e elasticitetit të veçantë, rrotat te jene me diametër 65mm, pesëkëmbëshi nga kromi 6-12 mikrona. Dimensionet – L64 W47 H110		410
6.	Karrige lëvizëse pa mbështetëse te kokës nga rrjeta e shtrire në kornizën metalike te formuar me myk te veçantë, pjesa e ulësës te jete me sfunxher te densitetit 50-55 DNS, te ketë mekanizëm me shume mundësi rregullim të pjerrësisë mbrapa, të ketë mbështetëse lumbare. Mbajtëset e duarve te jene lëvizëse poshtë/lart. Amortizuesi te jete i cilësisë se klasës 4 që është në përputhje me normat DIN evropiane dhe që ka karakteristikat e elasticitetit të veçantë, rrotat te jene me diametër 65mm, pesëkëmbëshi nga kromi 6-12 mikrona. Dimensionet – L64 W47 H92		469
7.	Garniture per pritje e cila duhet te jete e punuar nga korniza metalike me pluhur elektrostatik 8mm e mveshur me Eko - Lëkurë, kompensate e mbuluar me sfungjer te densitetit DNS (35 kg / m³) ne zonën e tapicierit, këmbët te jene nga druri shkoze dhe te jene te lyera me material mbushës ngjyrues me baze uji dhe ngjyre celuloze ne shtresën përfundimtare, pjesa e poshtme e këmbëve te jete me plastike, e mveshur me bio lëkurë. 7.1 Dy ulesi – 176x82x75		114

	7.2 Fotelja – 80x82x75		158
8.	Karrige statike me shkumë poliuretani të mveshura me Eko-Lekurë. Mbajtëset e duarve te jene te kromuara. Baza e kromit në formë të shkronjës U. Dimensionet Gjerësia e ulëses: 49 cm Thellësia e ulëses: 44 cm Lartësia e ulëses: 48 cm Lartësia e mbështetëses: 48 cm Gjerësia e mbështetëses: 49 cm Gjerësia e përgjithshme: 57 cm		1043
9.	Ulëse për pritje - Tre ulëse: Ulësja duhet te jete e punuar nga metali – Stainles steel, me tre vende për ulje nga min. 52cm, mbështetëse duarsh të fiksuara, ngjyrë e Argjend. Mbajtje e peshes: min. 320kg. Rezistente ndaj ndryshkut dhe lageshtisë. Dimensionet: Gjatësia: 180cm Lartësia: 80 cm Thellësia: 64 cm		247
10.	Ulëse për pritje - Tre ulëse: Ulësja duhet te jete e punuar nga metali – Stainles steel, me tre vende per ulje nga min. 52 cm, mbështetëse duarsh të fiksuara, ngjyrë e Argjend. Mbajtje e peshes: min. 320kg. Rezistente ndaj ndryshkut dhe lageshtisë. Pjesa e ulëses dhe e mbështetëses duhet të jenë të mbuluara me sfungjer dhe të mbeshtiehellura me Eko-lëkurë. Dimensionet: Gjatësia: 180cm Lartësia: 80 cm Thellësia: 64 cm		295
11.	Karrige rrotulluese për zyre Materiali skaj Ngjyra e zezë, e duarve-krahëve nga plastika, Ylli është i plastikes me 5 cepa, Dimenzioni 66 x 65 x 110-120 cm, Mekanizëm për lëvizje poshtë, lartë dhe mbrapa.		800



Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë 23000 Kosovë

Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo

SH.P.K



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë

Nr.unik 810631996

Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com

Web. www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111


Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

DEKLARATË E PËRSHTATSHMËRISË E SPECIFIKAVE TEKNIKE

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika" me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, deklarojmë dhe sigurojmë që inventarin të cilin ofrojmë i përshtaten specifikimit teknik të kërkuar në aneksin 1 të Dosjes së Tenderit.

Me respekt
Graniti sh.p.k





Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo
Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suhareke 23000 Kosovë

SH.P.K



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë
Nr.unik 810631996
Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com
Web. www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111

Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

LIFERIMI I INVENTARIT

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika" me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, ju njoftojmë që liferimin - transportimin e inventarit - mobiljet dhe elementet që ofrojmë do ta bëjmë në afat prej 30 dite pas pranimit te urdhërbljes, montimin dhe liferimin - transportimin e inventarit e bëjmë ne Graniti sh.p.k Suharekë, nëpër vendet e caktuara nga ana e AK.

Me respekt

Graniti sh.p.k





Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo
Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë 23000 Kosovë

SH.P.K



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë
Nr.unik 810631996
Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com
Web. www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111

Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

GARANCONI I INVENTARIT

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika " me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, per inventarin të cilin ofrojmë japim garancion 12 muaj nga pranimi i inventarit.

Me respekt

Graniti sh.p.k





Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë 23000 Kosovë

Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo

SH.P.K



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë

Nr.unik 810631996

Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com

Web. www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111

Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

DEKLARATË PËR DEFECTET EVENTUALE

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika" me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, deklarojmë dhe sigurojmë që inventarin të cilin ofrojmë, për ndonjë defekt eventual që mund të paraqitet periudha garantuese e defekteve eshte 12 muaj nga perfundimi I kontrates, të gjitha sanimet ne do ti kryejmë pa asnjë kompenzim.

Me respekt
Graniti sh.p.k





Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë 23000 Kosovo

Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë
Nr.unik 810631996
Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com
Web. www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111


Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

DEKLARATË PËR GARANCION TË PËRFORMANCËS PËR ELEMINIMIN E TË METAVE

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika" me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, deklarojmë se nëse ne e nënshkruajmë kontratën brenda 10 ditëve pas përfundimit të kontratës ne do të ofrojmë garancion të performances për eliminimin e të metave, nga një kompani të licencuar ne shumën prej 10% të vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 12 muajve.

Me respekt
Graniti sh.p.k





Address: Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suhareke 23000 Kosove

Welcome to Graniti furniture factory located in Suhareka Kosovo

SH.P.K



Rr.Ibrahim Rugova p/n Shirokë Suharekë,Kosovë

Nr.unik 810631996

Mob.: +383 45 111 201, Email: granitiholding@gmail.com

Web, www.graniti-ks.com

Emri i AK: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Adresa e AK: Rr. Ndërtesa e Gërmis -10 000 Prishtinë

Titulli: "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika"

Nr. i prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr. i brendshëm: AQP-22-019-111


Date : 23.01.2023

Vendi : Suharekë

CILËSIA DHE KUALITETI

Për tenderin me titull "Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika " me nr te Prokurimit: UA/2016-22-14086-111 Nr.i brendshëm: AQP-22-019-111, dëshmojmë për cilësi dhe kualitet,sipas standardeve europiane dhe dëshmi për këtë posedojmë me çertifikata ISO 9001:2000, ISO 9001:2008.

Me respekt
Graniti sh.p.k



"GRANITI" SHPK

04/05/2023

"GRANITI" SHPK PËRKATËSISHT THEMELUESI / PRONARI NXJERRË:

VENDIM

MBI CAKTIMIN E MENAXHERIT PËR :

**LOT 1 FURNIZIM ME INVENTAR ZYRTAR TAVOLINA PUNE DHE
ORMANA ME NUMËR IDENTIFIKUES: UA/2016-22-14086-1-1-
1& AQP 22-019-111 / C315**

DHE

**LOT 2 FURNIZIM ME INVENTAR ZYRTAR KARRIGA PUNE
ME NUMËR IDENTIFIKUES: UA/2016-22-14086-1-1-1& AQP 22-019-111
/ C315**

MENAXHER DO TË JETË:

BAJRAM LUMI

KONTAKTI: 044 - 111 - 572 dhe Emaili: granitiholding@gmail.com

04/05/2023

BAJRAM LUMI





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **113009**

Për **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **GRANITI SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karriga Lot 2**

Nr. prokurimit: UA/2016-22-14086-111 , Nr. brendshëm: AQP-22-019-111

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **38,377.70€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **38,377.70€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 396 ditë kalendarike prej **04.05.2023** deri më **03.06.2024**

Data lëshimit: 04.05.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

